



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 109-Korrik 2012 ZYRA PËR INFORMIM - [http://kk.rks-gov.net/malisheve/
www.malisheva-komuna.org](http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org)



Pamje nga Qendra e Bizneseve



Përmbajtja

Gati për korrje shirjet e sivjetme	2
U mbajt dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2013	3
KKSB bën thirrje për mospërdorim të armëve gjatë ahengjeve	4
KK miratoi Qarkoren e parë buxhetore dhe kornizën afatmesme buxhetore 2013-2015	5
Hapet Qendra për Mbështetje të Bizneseve në Malishevë	6
Njoftim nga kryesuesi i KK të Malishevës	7
Carralluka, së shpejti do të furnizohet me ujë për pije, pa reduktime	8
Sot përfundon fushata e korrjes së grurit në Malishevë	9
Komuna e Malishevës, i shpreh ngushëllime familjes Harvey	9
USAID-DEMI, mbajti seminarin për fushatën e të hyrave vetanake	10
U mbajt ceremoni komemorative kushtuar Randy Harvey	11



Gati për korrije shirjet e sivjetme

Malishevë, 2 korrik

Sot, në mbledhjen rregullt, të Këshillit të Drejtorëve e udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj, u bë e ditur se janë bërë përgatitjet për fushatën e korrije shirjeve për këtë vit, por edhe që kanë filluar të shtohen kërkesat për ujë të pijes.

Sipas drejtorit për bujqësi, z. Sinan Kryeziu, “Drejtoria e Bujqësisë, ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e fushatës së korrije shirjeve, duke formuar shtabin për përcjelljen e kësaj fushate”. Drejtori Kryeziu, bëri të ditur, se “këtë vit, do të jenë në dispozicion 36 kombajna nga komuna e Malishevës, ndërsa çmimi për korrjen e një hektari me grurë, do të jetë 100 €, përderisa derivatet për kombajner, nga ana e Ministrisë së Bujqësisë për këtë sezon do të jenë 25 për qind (subvencion)”.

“Viti i kaluar, ka qenë vit rekord për rendimente të grurit, ndërsa këtë vit, bazuar në kushtet e deritashme, pritet që rendimentet të jenë edhe më të mëdha”, tha drejtori Kryeziu, bazuar në gjendjen, aktuale të grurit, në arat e komunës së Malishevës.

Në anën tjetër, drejtori i shërbimeve publike, z. Alban Kastrati, bëri të ditur se “si pasojë e thatësirës së madhe, kanë filluar të shtohen kërkesat e qytetarëve për ujë të pijes”. Për këtë çështje, kryetari Kilaj, urdhëroi që të ndihmohen qytetarët të cilët kanë nevojë emergjente për tu furnizuar me ujë pijes.

U mbajt dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2013

Malishevë, 3 korrik

Nën organizimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa (DBF), sot është mbajtur dëgjimi i parë publik, mbi kornizën afatmesme buxhetore, qarkorja e parë, për vitin 2013-2015, me theks të veçantë për buxhetin e vitit 2013.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Vesel Krasniqi, buxheti i paraparë për vitin 2013, për Komunën e Malishevës, është 10.2 milion euro. “Edhe





këtë vit, buxheti për Malishevën, është ndarë për 52 mijë banorë, dhe jo sipas numrit të banorëve, i dalë nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ku Malisheva, ka rreth 70 mijë banorë”, tha drejtori Krasniqi.

“Sa i përket të hyrave vetanake të komunës, janë paraparë të realizohen rreth 750 mijë euro, për vitin 2013, apo marrë në përqindje rreth shtatë për qind e totalit të buxhetit të komunës”, tha drejtori Krasniqi.

KKSB bën thirrje për mospërdorim të armëve gjatë ahengjeve

Malishevë, 4 korrik

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në mbledhjen e radhës, të mbajtur sot, bëri thirrje që të mos përdoren armët, apo të mos ketë të shtëna, gjatë ahengjeve familjare, duke ju bashkuar kështu, fushatës së Policisë së Kosovës që “Gëzimi të mos shndërrohet në hidhërim”.

Komandanti i stacionit policor në Malishevë, toger Bekim Begaj dhe drejtori i drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj, bashkërisht, bën thirrje, për mos përdorim të armëve, gjatë ahengjeve familjare.

Në mbledhjen e sotme, drejtori i Drejtorisë Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj, njoftoi për spërkatjen selektive, të zonave endemike, si masë parandaluese, kundër infektimit me ethe hemorragjike. “Këtë vit kemi filluar me vonesë, për shkak të kushteve atmosferike, dhe si pasojë, kemi pasur një viktimë dhe dy raste të infektimi me ethe hemorragjike”, tha në raportin e tij, drejtori Zogaj.

Ndërsa, shefi i kësaj drejtorie, z. Ejup Zulfaj, njoftoi për rritjen e gatishmërisë të Shërbimit të Zjarrfikësve, për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, pasi sipas tij, “kjo dukuri, në këtë periudhë, është evidente, për shkak të hamulloreve dhe rritjes së temperaturave”. Zulfaj, bëri thirrje për kujdes të shtuar të qytetarëve, në këtë drejtim.

Ndërsa, komandanti i stacionit policor në Malishevë, togeri Bekim Begaj, njoftoi, se siguria e përgjithshme, është e qetë dhe stabile. “Në trasenë e autostradës, është një dukuri e vjedhjes së karburanteve, ku Policia e Kosovës, ka ndërmarrë një aksion për kapjen e hajnave dhe si pasojë kemi arrestuar një grup prej tetë personave”, njoftoi togeri Begaj. Ai më pas njoftoi edhe për shtim patrullave policore, në vendet më të frekuentuara, sidomos pishinave, për të krijuar siguri për qytetarët.

Në anën tjetër, edhe kapiteni i FSK-së, Xhavit Kelmendi, njoftoi se “FSK-ja ka rritur nivelin gatishmërisë, për situatave emergjente, sidomos gjatë këtyre muajve, ku mund të ketë, më shumë raste të fatkeqësive, siç janë zjarret dhe fatkeqësitë tjera”.



KK miratoi Qarkoren e parë buxhetore dhe kornizën afatmesme buxhetore 2013-2015

Malishevë, 5 korrik

Asambleja Komunale në Malishevë, në mbledhjen e shtatë të rregullt të këtij viti, me shumicë të votave, u miratua Qarkorja e parë buxhetore dhe Korniza afatmesme buxhetore 2013-2015, e shtruar në Asamblenë Komunale, nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Paraprakisht, në pikën e dytë të rendit të ditës, në mungesë të kuorumit, nuk u miratua kërkesa për iniciimin e procedurave për partneritet publiko-privat, përkatësisht dhënien me koncesion të pronës publike, e bartur nga mbledhja e katërt e Asamblesë Komunale.



Me kërkesën e opozitës, në këtë mbledhje, ka raportuar edhe drejtori për shëndetësi, z.Skënder Hoti, lidhur me gjendjen epidemiologjike, nga ethet hemorragjike në Komunën e Malishevës dhe trajtimi i shumë rasteve në QKUK. “Nga numri i madh i të thumbuarve nga rriqrat, këtë vit janë regjistruar katër raste me ethe hemorragjike, ku një rast ka përfunduar me humbje jete”, tha drejtori Hoti, dhe shfrytëzoi rastin që edhe publikisht ti shpreh ngushëllime familjes, që ka humbur një anëtar të familjes nga ethet hemorragjike. Më pas drejtori Hoti, raportoi edhe për fushatat e drejtorisë së shëndetësisë, lidhur me ethet hemorragjike dhe spërkatjen e zonave endemike.

Asamblistët, kërkuan më shumë angazhim nga ana e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror, për luftimin e etheve hemorragjike dhe spërkatjen kundër rriqrave, si bartës të këtij virusi.

Po ashtu në këtë mbledhje, është trajtuar edhe çështja e tokave të fshatrave Bellanicë, Banjë, Senik dhe Lladrovç. Shumica e këshilltarëve komunal, vlerësuan se janë organet kompetente ato që mund ta trajtojnë këtë çështje.



Me shumicë të votave, këshilltarët komunal, vendosën që kërkesa e fshatrave Panorc dhe Rud, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e xhamisë për këto dy fshatra, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, për shkaqe procedurale. Po ashtu, edhe kërkesa e përfaqësuesit të Bashkësisë Islame në Malishevë, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e xhamisë për fshatin Goriq.

Hapet Qendra për Mbështetje të Bizneseve në Malishevë

Malishevë, 10 korrik

Sot, edhe zyrtarisht, është bërë hapja e Qendrës për Mbështetje të Bizneseve në Malishevë, e cila është ndërtuar nga Zyra e Unionit Evropian (EU) në Kosovë dhe Komuna e Malishevës, e cila do të jetë në shërbim të komunitetit të biznesit në Malishevë. Shiritin e përrimit e prenë, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, përfaqësuesi i Zyrës Ndërlidhëse të Këshillit Evropian në Kosovës, z.Christof Stock dhe kryetari i shoqatës së bizneseve të Malishevës, z.Daut Krasniqi.



“Sot për përrurojmë, Qendrën e Biznesit në Malishevë, të financuar nga Zyra e Unionit Evropian dhe komuna jonë. Ky është sukses i Zyrës së Unionit Evropian dhe Komunës së Malishevës, por është edhe një sukses i madh i komunitetit të biznesit të Malishevës, të cilët ndihmuan dhe janë përfitues të këtij objekti. Qytetarët do të mund të shfrytëzojnë këto ambiente për të përfituar mbështetje, si këshilla, trajnime, seminare, projekte biznesi, takime të këtij komuniteti dhe shërbime tjera. Nga sot, ky komunitet do të ketë kushte shumë më të mira”, tha mes tjerash, në fjalën e rastit, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj.

Ndërsa, Christof Stock, nga Zyra Ndërlidhëse e Këshillit të Evropës në Kosovë, pasi uroi dhe shprehi kënaqësinë, që kishte rastin ta bënte hapjen e kësaj qendre, tha se “kjo qendër do të ndikoj shumë në biznesin e Malishevës, ndërsa Malisheva, do të ndikoj në zhvillimin e përgjithshëm në Kosovë, për shkak të përparësive që ka, si udhëkryq i të gjitha rrugëve të Kosovës, pastaj ka turizmin malor dhe ka një udhëheqje shumë të mirë dhe të suksesshme”.



Stock, pasi foli për rëndësinë e kësaj qendre në mbështetje të bizneseve, tha se “kjo është që të tregohet se çka mund të kontribuoj Malisheva në zhvillimin e Kosovës”.

“Sot duhet të jemi të gëzuar për këtë qendër për mbështetje të bizneseve. Pas shumë sfidave sot kemi lehtësi për shërbimet biznesore”, tha kryetari i shoqatës së bizneseve të Malishevës, z.Daut Krasniqi, në fjalën e tij, dhe falënderoi të gjithë ata që kanë kontribuar në ndërtimin e kësaj qendre.

Ndërtimi i këtij objekti, ka kushtuar rreth 330 mijë euro dhe është bashkëfinancim i Zyrës Ndërlidhëse të Këshillit Evropian në Kosovë dhe Komunës së Malishevës.

Njoftim nga kryesuesi i KK të Malishevës

Malishevë, 12 korrik

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës, z.Ragip Begaj, përmes një njoftimi publik, njofton se “në mbledhjen e fundit të KK të Malishevës është vendosur që mbledhja e radhës të mbahet me datën 3 gusht 2012. Përkundër gatishmërisë së kryesuesit për mbajtjen e mbledhjes, një gjë e tillë është e pamundur pasi një pjesë e anëtarëve të KK-së janë në pushime sikurse edhe një pjesë e ekzekutivit komunal që po ashtu është në pushime, kurse ka kërkesë nga një pjesë tjetër e anëtarëve të kuvendit që gjysma e muajit korrik sikurse edhe muaji gusht të jenë muaj të pushimeve”.

Në këtë kuptim, ju njoftoj se mbledhja e paraparë për dt. 3 gusht 2012 do të mbahet në fund të muajit gusht të viti 2012.

Ky njoftim mund tu shërbejë edhe si mundësi për planifikimin e pushimeve tuaja vjetore.

Shpresoj në mirëkuptimin tua

Kryesuesi i KK të Malishevës

Ragip Begaj

Carralluka, së shpejti do të furnizohet me ujë për pije, pa reduktime

Malishevë, 19 korrik



Banorët e fshatit Carrallukë, së shpejti do të kenë furnizimin të rregullt me ujë për pije, pasi ka filluar ndërtimi i nënstacionit të pompimit në Malishevë, për ta furnizuar këtë fshat, në mënyrë të rregullt me ujë, bëri të ditur sot njësia e “Hidroregjionit” në Malishevë dhe Drejtoria Komunale e Shërbimeve Publike.

“Ndërtimi i këtij nënstacioni të pompimit, do të zgjidh përfundimisht problemin e furnizimit me ujë për këtë fshat”, tha drejtori i Shërbimeve Publike, z.Alban Kastrati, ndërsa përgjegjësi i njësisë së “Hidroregjionit

jugor”, në Malishevë, z.Njazi Bytyçi, tha se “ për shkak të thatësisë së madhe dhe keqpërdorimeve të ujit, banorët e Carrallukës, deri më tani, nuk kanë mundur të kenë furnizim me ujë për pije”.

Projekti i ndërtimit të nënstacionit, do të kushtoj rreth 17 mijë euro, ndërsa bashkëfinancohet nga Komuna e Malishevës me 10 mijë euro, ndërsa pjesën tjetër e mbulon “Hidroregjioni jugor”.

Përndryshe, gjendja me ujë për pije , në vendbanimet ku ka sisteme të ujësjellësit, është e mirë dhe reduktime ka vetëm në Malishevë dhe Banjë, kurse brenda dhjetë ditëve, pritët që edhe Carralluka të ketë furnizim të mirë me ujë.

“Përrjashtuar Malishevën dhe Banjën, që ka reduktime, në vendbanime tjera që menaxhohen ujësjellësit nga “Hidroregjioni”, furnizimi është 24 orë me ujë, varësisht edhe nga furnizimi me rrymë që nganjëherë pengon edhe furnizimin me ujë”, tha Bytyçi.

Në anën tjetër, drejtori i Shërbimeve Publike, z.Alban Kastrati, bëri të ditur, se “në disa fshatra të Malishevës, si Drenoci, Bubaveci, Balinca, Maralia dhe Pagarusha, të cilat nuk kanë sistem të ujësjellësve, ka filluar të keqësohet gjendja me ujë për pije, për shkak të thatësisë së madhe që po mban kohëve të fundit”. “Komuna është duke bërë përpjekje maksimale, të t’ju dal në ndihmë për ti furnizuar me ujë për pije, të gjithë ata që e kërkojnë një gjë të tillë, e sidomos rasteve sociale”.



Sot përfundon fushata e korrjes së grurit në Malishevë

Malishevë, 20 korrik

Fushata e korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Malishevës, pritet të përfundoj gjatë ditës së sotme, ndërsa gjatë kësaj fushate nuk janë shënuar probleme, kurse rendimenti mesatar është rreth katër mijë kilogram grurë për një hektar.

“Sot presim të përfundoj fushata e korrjes së grurit, për rreth 3 600 hektarëve sa kanë qenë të mbjella me grurë, tërësisht në sektorin privat dhe e tërë fushata ka kaluar pa probleme”, tha drejtori i Drejtorisë Komunale për Bujqësi, z.Sinan Kryeziu, bazuar në raportin e shtabit komunal për korrje shirje.

“Kanë qenë të angazhuara mbi 50 kombajna, prej tyre 36 kombajna të Komunës së Malishevës, ndërsa të tjerat nga komunat përreth, kurse furnizimi me derivate për kombajna është bërë sipas planit dhe ka shkuar shumë mirë”, njoftoi drejtori Kryeziu.

“Rendimentet janë sjellë rreth 4000 kilogram grurë për një hektar”, tha Kryeziu.

Komuna e Malishevës, i shpreh ngushëllime familjes Harvey

Malishevë, 24 korrik

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, në emër të institucionit të Komunës dhe qytetarëve të Komunës së Malishevës, i shpreh ngushëllime familjes Harvey, me rastin e vdekjes së hershme të kryefamiljarit Randy Harvey.

“Në emër të Komunës së Malishevës dhe në emrin tim personal, ju shprehi ngushëllimet më të singerta dhe keqardhjen për vdekjen e hershme të kryefamiljarit tuaj, Randy Harvey. R. Harvey, ka qenë jo vetëm një qytetar amerikan, banor i Malishevës, por një humanist dhe sportist i dalluar, duke dhënë kontribut të çmuar në Komunën e Malishevës. Andaj, pranoni ngushëllimet e tona. I përjetshëm qoftë kujtimi për të”, thuhet në telegramin e ngushëllimit të nënkryetarit të Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku.

Randy Harvey, ka vdekur sot, pas një sëmundje të shkurtër. R. Harvey, me shtetësi amerikano-kosovare, ishte banor i Komunës së Malishevës. Randy Harvey dhe familja Harvey, kanë dhënë kontribut të çmuar në aspektin humanitar, në arsim, kulturë dhe sport.

USAID-DEMI, mbajti seminarin për fushatën e të hyrave vetanake

Malishevë, 25 korrik

USAID, në kuadër të programit të saj Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI), ka mbajtur sot në Malishevë, seminarin për “Krijimin e konsensusit për fushatën e të hyrave vetanake”. Seminarin e udhëhoqi znj. Deborah Kimble, udhëheqëse e njësisë për Administratë dhe Kuvend, projektit USAID-DEMI, ndërsa pjesëmarrës ishin këshilltar komunal, zyrtar të drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe zyrtar të tjerë komunal.



Objektiv i këtij seminary ishte, ofrimi i hapësirës në të cilën Komuna dhe Kuvendi, mund të shqyrtojnë situatën me të hyrat vetanake në komunë dhe për të arritur në një konsensus në lidhje me strategjinë për ngritjen e të hyrave vetanake, me theks të veçantë në ngritjen e të hyrave vetanake përmes ngritjes së inkasimit të tatimit në pronë.

Seminari është mbajtur në tri pjesë: 1. Fushata për ngritjen e të hyrave vetanake: Praktikë e suksesshme ndërkombëtare dhe nacionale, 2. Analiza e të hyrave vetanake: Ndikimi i ndryshimeve në ligje regjistrimin e popullsisë dhe 3. Arritjen e konsensusit mbi Fushatën e Tatimit në Pronë.

Gjatë seminarit, pjesëmarrësit, kanë dhënë mendimet e tyre për mënyrën e komunikimit me publikun, me qëllim të ngritjes së të hyrave nga tatimi në pronë, arsyet e kryerjes së obligimit për tatimin në pronë dhe mënyrën se si tatimi në pronë ju kthehet qytetarëve përmes investimeve të drejtpërdrejta dhe formave të tjera.

U mbajt ceremoni komemorative kushtuar Randy Harvey

Malishevë, 26 korrik



Në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, u mbajt një ceremoni komemorative kushtuar kosovaro-amerikanit Randy Harvey, i cili vdiq dy ditë më parë. Në këtë komemoracion, përveç familjarëve, morën pjesë edhe zyrtar të lartë të Komunës së Malishevës, të Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, KFOR-it, miq të R. Harvey-t dhe qytetar të shumtë.

Në këtë komemoracion u fol për jetën dhe veprimtarin e ish ushtarakut amerikan, i cili viteve të fundit ishte bërë banor i Komunës së

Malishevës, ndërsa kishte dhënë kontribut të madh në aspektin humanitar, pastaj në sport dhe në sfera të tjera në Komunën e Malishevës.

Paraprakisht, në hollin e Shtëpisë së Kulturës, janë bërë homazhe pranë arkivolit me trupin e të ndjerit Randy Harvey.

Në këtë komemoracion, në emër të Komunës së Malishevës, një fjalim rasti mbajti, nënkryetari z. Rexhep Mazreku.

Në vazhdim, fjalimi i plotë i nënkryetarit:

Fjalë mortore në emër të Komunës së Malishevës me rastin e vdekjes së qytetarit Randy Preston Harvey

E nderuara familja e Randy Harvey,

Të nderuar përfaqësues nga ambasada amerikane në Kosovë,

Të nderuara autoritete ushtarake dhe të sigurisë nga KFOR-i amerikan në Kosovë,

Të nderuara familje të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-ës

Të nderuar përfaqësues të klerit fetar,



Të nderuar autoritete lokale dhe të nivelit qendrorë,

Të nderuar të gjithë ju pjesëmarrës,

Ishte shumë i vështirë dhe i hidhur lajmi që morëm për vdekjen e papritur të qytetarit tonë të nderuar dhe shumë të çmuar Randy Preston Harvey. Përdje ishte dita e fundit që ne të shohim fisnikërinë e tij prej qytetari, ishte dita e fundit për ne që të shohim bujarinë e tij njerëzore që e dëshmonte me përkushtimin më të madh të tij dhe familjes së tij, për të qenë pjesë aktive e vendit tonë.

Vdekja e hershme e Rendi na la me zemra të thyera, duke na ndaluar që në shumë fusha jetësore të punojmë dhe jetojmë së bashku, duke na lënë poashtu të vetmuar që ta kemi në mesin tonë edhe me gjatë me vetmohimin e tij qytetar.

Duke bashkëndjerë dhembjen e thellë për vdekjen e papritur të Rendi më lejoni që të ndaj pak fjale dhembjeje për veprën e tij të madhe jetësore që dha për Malishevën dhe qytetarët e saj.

Randy Preston Harvey apo si e njohëm ne Rendi, ishte qytetari i jonë, që erdhi nga SHBA për të na ndihmuar fillimisht dhe më pas vendosi për të jetuar me nder dhe dinjitet në mesin tonë, ai erdhi bashkë me familjen e tij për të jetuar me ne, për të na ndihmuar në rindërtimin e komunës sonë, për të na ndihmuar në konsolidimin e jetës institucionale dhe shoqërore, duke sjellë përvojën nga vendi i tij, që për ne mbetet vendi më miqësor dhe kjo miqësi nuk është e rastësishme ajo trashëgohet me shekuj. Kjo ishte mbështetja më e madhe për ne që të kemi një qytetar amerikan në Malishevën e atëhershme e posa dalur nga lufta. Randy Harvey për qytetarët dhe institucionet e tona kujtohet me pietetin më të lartë vëllazërorë e qytetar, ai në Malishevë solli buzëqeshjen qytetare duke hapur porta të reja në ndërtimin e vendit. Humaniteti dhe kultura e tij qytetare bënë që komuna e Malishevës dhe qytetarët e saj të përfitojnë një mik të madh, që me përkushtimin më të lartë dëshmoj se dëshiron të i takojë Malishevës dhe qytetarisë së saj. Andaj Malisheva dhe qytetarët e saj e pranuan me zemërgjerësinë më të madhe që Randy Preston Harvey të bëhet banor i komunës së Malishevës bashkë me familjen e tij.

Liga shqiptare amerikane dhe bashkëpunimi në mes shqiptarëve dhe amerikanëve ndërtoj urat më të fuqishme të bashkëpunimit në mes popujve tanë. Rendi dhe familja e tij dhe organizatat që përfaqësonte, dhanë shumë në zhvillimin e komunës së Malishevës dhe të Republikës së Kosovës në përgjithësi, dhe vërtetuan sesa i fuqishëm është bashkëpunimi ynë. Malisheva ishte e nderuar që Rendi dhe familja e tij vendosi të jetonte në Malishevë. Pra, ai pëlqente vendin tonë dhe vet e thoshte që: „Njerzit e mirë dhe të singertë më kanë ndal të jetojë në Malishevë”.

Komuna e Malishevës dhe qytetarët e saj nuk do ta donin humbjen e hershme të Rendi sepse ky vend kishte nevojë edhe më tej për buzëqeshjen e tij, punën e tij humanitare, përkrahjen e tij për arsimin, kulturën dhe sportin sepse kishin nevojë poashtu, për përvojën e tij profesionale dhe angazhimin shumë dinjitoz dhe qytetarë.



Do të kujtojmë përherë kontributin e tij dhe atë në ;

Sigurimin e medikamenteve mjekësore për më tepër se 1520 persona;

Sigurimin e pajisjeve rehabilituese fizike mjekësore për shumë invalidë të luftës;

Përkrahjen financiare për familje të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe rasteve sociale;

Përkrahjen e komunitetit të biznesit në projekte të shumta investive, hapjen e internet cafe së parë në Malishevë;

Ndarjen e dhjetëra mijëra dhuratave për fëmijët me rastin e festave të Krishtlindjes;

Sigurimin e veshëmbathjesë për shumë familje të komunës sonë e më gjerë;

Përkrahjen e shumë bibliotekave shkollore të komunës sonë;

Organizimin e shumë kurseve falas në gjuhë angleze dhe kompjuterizim për shumë fëmijë e studentë të komunës sonë;

Përkrahjen e shumë nismave shoqërore në të gjitha rrjedhat e zhvillimit të komunës sonë.

Në shenjë të respektit për bashkëjetesën dhe veprimtarinë e tij jetësore komuna e Malishevës i ndau edhe trollin për ndërtimin e shtëpisë, ku sot familja Harvey i gëzohet jetës malishevase bashkë me të gjithë miqtë dhe të afërmit e saj.

Sot komuna e Malishevës bashkëndjen dhembjen me shokun e jetës së Rendit, zonjën Lisha e cila është sinonim i bashkëshortes së vërtet dhe sukseset e Rendit në këtë botë ishin njëkohësisht edhe përkrahje vetëmohuese e Lishës dhe fëmijevë të tyre.

E nderuara dhe e respektuara familja Harvey,

Po i themi lamtumirën e fundit bashkëqytetarit tonë Rendi Preston Harvey duke ruajtur kujtimet më të bukura për shëmbëlltyrën e tij jetësore. Komuna e Malishevës dhe të gjithë bashkëqytetarët tuaj sot janë me ju, dhe do të jenë pranë jush përherë, duke bashkëjetuar, që të zhvillojmë sa më shumë vendin tonë. Rendi ishte shembulli më i mirë se si duhet të jetë njeriu në jetë, si: shok, mik, qytetar, punëtor, sportist, i kulturuar e arsimdashës, familjar , bashkëshort e prind .

Më lejoni që në emër të kryetarit Kilaj, timin personal dhe të gjithë qytetarëve e institucioneve tona të ju shprehim ngushëllimet më të sinqerta për vdekjen e hershme të Randy Preston Harvey.

Lavdi veprës së tij jetësore, I përjetshëm qoftë kujimi për të!



Malishevë, 26 korrik 2012

Nënkryetari i komunës:

Rexhep Mazreku